

UDHËZIM
Nr. 15, datë 18.5.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT NGA
ÇDO PERSON NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E MARRËVESHJEVE
NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN TATIMORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 61/1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për qëllime të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet tatimore dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë asistencë administrative në çështjet tatimore dhe janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kërkon informacion ndaj/dhe për çdo person, përfshirë, por pa u kufizuar, në informacionin e mbajtur nga banka dhe institucione të tjera financiare.

2. Çdo person, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën tatimore, jep informacionin e kërkuar sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Për informacionin e dhënë, në zbatim të këtij udhëzimi, zbatohen të njëjtat rregulla si për informacionin e dhënë për qëllime të zbatimit të legjislacionit vendës, përveç kur në marrëveshjet ndërkombëtare është parashikuar ndryshe.

4. Në rast të paraqitjes së një kërkesë në zbatim të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, nga një autoritet tatimor i një shteti tjetër me të cilin ka një marrëveshje ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga autoriteti i huaj, i drejton një kërkesë me shkrim personit, i cili disponon informacionin e kërkuar. Në kërkesë specifikohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit për të cilin kërkohet informacioni për qëllime tatimore, periudha dhe arsyeja e kërkesës së këtij informacioni.

5. Në kërkesën e paraqitur ndaj personit, sipas përcaktimeve të pikës 4, specifikohen dhe penalitetet që aplikohen sipas dispozitave të nenit 126, “Mosdhënie e informacionit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rastet e mosdhënies së informacionit nga ky person.

6. Personi ndaj të cilit kërkohet informacioni, brenda 30 ditëve nga data që kërkesa është marrë ose vlerësohet të jetë marrë, paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në formë shkresore, informacionin e kërkuar.

7. Në rast të mosdhënies së informacionit brenda afateve të përcaktuara, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masat për aplikimin e penaliteteve, sipas nenit 126 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

8. Me marrjen e informacionit të kërkuar, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve, i kthen përgjigje autoritetit tjetër tatimor. Në çdo rast, përgjigja, përveç informacionit të kërkuar, përmban edhe kërkesën ndaj autoritetit tjetër tatimor mbi zbatimin e detyrimit për përdorimin konfidencial dhe ruajtjen e sekretit të këtyre informacioneve, njëloj siç veprohet me informacionet e brendshme, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe me dispozitat e marrëveshjes tatimore, si dhe përdorimin e këtij informacioni vetëm për qëllime tatimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani